

PROCES VERBAL ASAMBLESË SË ORTAKËVE
Tiranë, 12.01.1996

Sot më 12 Janar 1996 në orën 14³⁰ në selinë e QENDRËS TREGTARE DHE ZHVILLIMIT KULTUROR Sh.p.k. u mbledh Asambleja e Ortakëve për të diskutuar e vendosur sipas rendit të ditës si më poshtë vijon :

1. Trasferim eventual i disa quoteve Shoqërisë SIMEST S.p.A. nga ortaku italian TECNOSYSTEM ENGINEERING S.r.l.
2. Të ndryshme dhe eventuale.

Përveç presidentes së Shoqërisë Znj. Geisu Basha janë të pranishëm të gjithë ortakët, që përfaqësojnë të gjithë kapitalin shoqëror. Asistojnë në Asamble ekspertë kontabil. Asambleja eakton me unanimitet në cilësinë e sekretarit Z. Vincenzo Pastorella.

Presidenti pasi konstaton praninë e të gjithë kapitalit shoqëror deklaron të regullt mbledhjen e Asamblesë dhe autorizon fillimin e punimeve. Duke kaluar në trajtimin e çështjes së parë të rendit të ditës, Presidenti informon për mbi mundësinë që SIMEST S.p.A. (Shoqëri Italiane për Ndërmarrjet e Përbashkëta me Jashtë) me qëndër në Romë, Rr. Farnese, nr. 4 (Itali) mund të blejë së shpejti një kuotë të kapitalit shoqëror të Joint Venture - Qendra Tregtare dhe Zhvillimit Kulturor Sh.p.k. të barabartë me 437.250 USD (43.725.000 Lekë) d.m.th. baraz me 15 % të kapitalit të përgjithshëm shoqëror prej 2.915.000 USD sipas marveshjes ndërmjet SIMEST S.p.A. e ortakut italian TECNOSYSTEM ENGINEERING s.r.l. Kjo kuotë do të riblihet nga po e njëjta shoqëri TECNOSYSTEM ENGINEERING s.r.l. brenda një date të përcaktur me SIMEST S.p.A.

Lidhur me transferimin e më vonshëm të kuotës nga ana e SIMEST S.p.A. nuk do të aplikohet nga ortakët e drejta e parablerjes.

Asambleja e Ortakëve mban shënim për gjithshka si dhe për heqjen dorë nga ortaku shqiptar për ushtrimin e së drejtës së parablerjes e aprovon me unanimitet duke pranuar shprehimisht heqjen dorë nga e drejta e precedencës nga ana e ortakëve për shitjen e më vonëshme të kuotës nga SIMEST S.p.A.

Duke mos patur asgjë tjetër për të vendosur Presidenti shpërmdan Asamblenë e Ortakëve në orën 14³⁰ mbas redaktimit, leximit paraprak e miratimit të këtij proces verbal.


Presidenti
GEISU BASHA

Çerçiz Hoxha

Benio Piroficio

Sekretar

Vincenzo Pastorella





KONTRATE - SHITJE KUOTASH

Nr. 1538 rep.
Nr. 542 kol.

CU

Sot me date 19.07.1996, ne dhomen e noterise ne Tirane para meje noteres, u paraqiten personalisht:

SHITESI: Tecnosystem Engineering S.r.l. perfaqesuar nga presidenti i saj Giovanni De Gennaro, madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar, me pasaporte N° 11270871.....

BLERESI: SHOQERIA SIMEST S.p.A., perfaqesuar nga presidenti i saj RUGGERO MANCIATI, madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar, me pasaporte N° 5669474;

Te cilet, deklarojne se lidhin kete kontrate shitje:

Shoqeria Tecnosystem Engineering S.r.l. si ortak ne Shoqerine me Pergjegjesi te Kufizuar "Qendra Tregtare Dhe E Zhvillimit Kulturor Sh.p.k.", me kuote 55% te kapitalit themeltar prej 291.500.000 leke, deklarone me vullnetin e saj te lire dhe te plote me ane te presidentit te saj se 15% te kuotave te saj, kundrejt cmimit 43.725.000 leke ja shet shoqerise "SIMEST S.p.A.".

Shoqeria "SIMEST S.p.A.", deklarone me vullnetine saj te lire dhe te plote se pranon blerjen e kesaj pjese te kuotes se kapitazit themeltar te pershkruar si me siper dhe se ata jene likujduar me njeri tjetrin dhe nuk kane me asnje lloj detyrimi ne lidhje me kete shitje te kuotave te shitura nga shoqeria "Tecnosystem Engineering S.r.l.".

Kontrata e shitjes, mbasi ju lexua paleve dhe u gjet sipas vullnetit te lire dhe te plote neneshkruhet rregullisht prej tyre para meje noteres dhe une note

SHITESI
Giovanni De Gennaro

TECNOSYSTEM
ENGINEERING s.r.l.

PULLE TAKSE




100
LEKE
R-SHQIPËRISE

PALET

NOTERE



SIMEST S.p.A.
Via Farnese 4
00192 ROMA



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E SHKALLES SE PARE TIRANE
Nr. Vendimit 6730/11

VENDIM I GJYOTARIT TE VETEM

Ne Tirane, sot, me daten 15 shtator 2005, une, Gjyqtarja e Gjykates se Shkalles se Pare, Tirane, **Blerina Muca**, mora ne shqyrtim kerkesen e paraqitur nga z.Vincenzo Pastoressa, ne emer te shoqerise " Qendra Tregetare e Zhvillimit Kulturor ", Tirane, dhe te dokumentave te tjera bashkelidhur,

konstatova

- se, kerkuesi **Vincenzo Pastoressa** eshte administratori i shoqerise " Qendra Tregetare e Zhvillimit Kulturor " Sh.p.k., me qender legale Sheshi Skenderbej, Pallati i Kultures, Tirane, regjistruar me Vendimin e Gjykates se Rrethit Tirane, nr.6730, date 15.09.1993, me kapitalin themeltar prej leke 291.500.000 leke;

- se, perkatesia e perfagesimit te ortakeve ne kapitalin themeltar eshte, si vijon :
Ministria e Kultures (Pallati i Kultures)

Shoqeria Tecnosystem Engineering S.r.l.	131.500.000 leke ose 45 perqind
Shoqeria SIMEST S.p.A.	116.275.000 leke ose 40 perqind
	43.725.000 leke ose 15 perqind.

- se, me vendimin e Asamblese se Ortakeve te shoqerise Q.T.ZH.K. Sh.p.k., date 12 janar 1996, eshte vendosur :

Shitja e 15 perqind te kuotes se shoqerise, ne vleren prej 437.250 USD ose 43.725.000 leke, te zoteruara nga ortaku, shoqeria Tecnosystem Engineering S.r.l., ne favor te shoqerise SIMEST S.p.A..

Kuota prej 15 perqind shitur shoqerise SIMEST S.p.A. do te riblihet perseri nga ortaku Tecnosystem Engineering S.r.l., brenda nje kohe te percaktuar me SIMEST S.p.A.

Lidhur me transferimin e mevonshem te kuotes nga ana e SIMEST S.p.A. nuk do te aplikohet nga ortaket e drejta e parablerjes.

Aprovimin me unanimitet te shprehur te heqjes dore nga ortaku shqiptar nga e drejta e parablerjes, per shitjen e mevoneshme te kuotes nga SIMEST S.p.A.

- se, me daten 19.07.1996, me kontraten noteriale nr.rep.1538 e nr.kol.542, te noteres Nimete Karamani, Tirane, te nenshkruar ndermjet shitesit, shoqeria Tecnosystem Engineering S.r.l. dhe bleresit, shoqeria SIMEST S.p.A., eshte realizuar shitja e 15 perqind te pjeseve te kapitalit themeltar te shoqerise Q.T.ZH.K. Sh.p.k., ne vleren prej 43.725.000 leke,

- se, vendimi i asamblese se ortakeve date 12.01.1996, sebashku me dokumentat e tjera perkatese, eshte konfirmuar dhe depozituar prane Regjistrin Tregetar Tirane, ne baze te Vendimit te Gjykates se Rrethit Tirane, nr.6730/3, date 23.09.1998.

- se, ne baze te vendimit te asamblese se ortakeve te shoqerise, date 12.01.1996, ndermjet shitesit SIMEST S.p.A. dhe bleresit Tecnosystem Engineering S.r.l., me daten 09.08.2005, eshte perfunduar riblerja e pjeseve te kapitalit themeltar prej 15 perqind te shoqerise Q.T.ZH.K. Sh.p.k., ne favor te ketij te fundit, me vleren prej 43.725.000 leke

- se, kerkesa e paraqitur eshte e drejte dhe si e tille duhet pranuar.

Per keto aresye

Bazuar ne kerkesat e ligjit 7638/1992 dhe 7667/1993


Vendosa

- 1) Pranimin e kerkeses se administratorit te shoqerise " Qendra Tregetare e Zhvillimit Kulturor " Sh.p.k., z.Vincenzo Pastoressa..
- 2) Depozitimn ne Regjistrin Tregetar te kontrates se shitjes se dates 09 gusht 2005, me nr.rep.8674 dhe nr.rep.2191, ndermjet shoqerise SIMEST S.p.A., si shites dhe shoqerise Tecnosystem Engineering S.r.l., si bleres.
- 3) Urdherimin e Zyres se Regjistrin Tregetar Tirane, per te bere ndryshimet perkatese.

Kunder ketij vendimi mund te behet ankim ne Gjykatën e Apelit, Tirane.

GJYQTARE

Blerina Muca



REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
NOTERE MIMOZA SHEHU
Nr.Rep.
Nr.Kol.



KONTRATE E SHITJES SE PJESEVE TE KAPITALIT THEMELTAR

Ne Tirane, sot, me daten 9 gusht 2005, ne studion time ne Tirane, Bulevardi " Abdyl Frasheri ", Pall.3, Sh.3, Ap.1, perpara meje noteres Mimoza Shehu ne Tirane, jane paraqitur palet kontraktuese :

1) Shoqeria italiane Tecnosystem Engineering S.r.l., me qender legale ne Bari (It.), Rruga " Devitofrancesco ", nr.31/c, regjistruar ne Regjistrin Tregetar te Gjykates se Barit te Italise, me nr.33444, regjistruar ne Dhomen e Tregetise dhe Industrise Bari (It.), me nr.333814, me Kodin Fiskal Nr.04790250726,
- perfaqesuar nga perfaqesuesi i saj ligjor, ai dhe Kryetari i Keshillit Administrativ te shoqerise, Av.Giovanni Degennaro, ne baze te nenit 45 te statutit te shoqerise, identifikuar me Pasaporten Nr. B 632395, ketu bashkelidhur kopja.
- ne kete kontrate do te emertohet pala Blerese.

dhe

2) Shoqeria italiane SIMEST S.p.A., me qender legale ne Rome, Rruga " Corso Vittorio Emanuele 2 ", nr.323, 00186 Roma, regjistruar ne Regjistrin Tregetar Rome dhe me Kodin Fiskal - PI 041028910001 - REA nr.730445.
- perfaqesuar nga Drejtori i Pergjithshem i shoqerise, z. Massimo D'Aiuto, identifikuar me Pasaporten Nr 091055X, ketu bashkelidhur kopja.
- ne kete kontrate do te emertohet pala Shitese.

Palet parashtrojne :

a) se, jane ortake te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar " Qendra Tregetare e Zhvillimit Kulturor " Sh.p.k., me qender legale ne Tirane, Sheshi Skenderbej, Pallati i Kultures, Tirane, regjistruar si person juridik ne Regjistrin Tregetar, me vendimin e Gjykates se Rrethit, Tirane, nr.6730, date 15.09.1993, me kapitalin themeltar prej leke 291.500.000 leke.

b) se, me vendimin e Asamblese se Ortakeve te shoqerise Q.T.ZH.K. Sh.p.k., date 12.01.1996, eshte vendosur :
- shitja e 15 perqind te kuotes se shoqerise, ne vleren prej 437.250 USD ose 43.725.000 leke, te zoteruar nga ortaku, shoqeria Tecnosystem Engineering S.r.l., ne favor te shoqerise SIMEST S.p.A.
- Kuota prej 15 perqind shitur shoqerise SIMEST S.p.A. do te riblihet perseri nga ortaku Tecnosystem Engineering S.r.l., brenda nje kohe te percaktuar me SIMEST S.p.A.

h

h

h

1

h

- Lidhur me transferimin e mevonshem te kuotes nga ana e SIMEST S.p.A. nuk do te aplikohet nga ortakët e drejta e parablerjes.

- Aprovimin me unanimitet te shprehur te heqjes dore nga ortaku shqiptar dhe nga ortakët e tjere nga e drejta e parablerjes, per shitjen e mevoneshme te kuotes nga SIMEST S.p.A.

c) se, me daten 19.07.1996, me kontraten noteriale nr.rep.1538 e nr.kol.542, te noteres Nimete Karamani, Tirane, te nenshkruar ndermjet shitesit, shoqeria Tecnosystem Engineering S.r.l. dhe blesesit, shoqeria SIMEST S.p.A., eshte realizuar shitja e 15 perqind te pjeseve te kapitalit themeltar te shoqerise Q.T.ZH.K. Sh.p.k., ne vleren prej 43.725.000 leke,

d) se, ne baze te Vendimit te Gjykates se Rrethit Tirane, nr.6730/3, date 23.09.1998, perkatesia e perfaqesimit te ortakëve ne kapitalin themeltar eshte, si vijon :

- Ministria e Kulture, Rinise dhe Sporteve	131.500.000 leke ose 45 perqind.
- Shoqeria Tecnosystem Engineering S.r.l.	116.275.000 leke ose 40 perqind
- Shoqeria SIMEST S.p.A.	43.725.000 leke ose 15 perqind.

e) se, ne baze te vendimit te asamblese se ortakëve te shoqerise, date 12.01.1996, shitesi deshiron te cedoje dhe te transferoje 15 perqind te pjeseve te kapitalit themeltar te zoteruara prej tij ne shoqerine Q.T.ZH.K. Sh.p.k.

f) se, ne baze te vendimit te asamblese se ortakëve te shoqerise, date 12.01.1996, blesesi deshiron te bleje pjeset e kapitalit themeltar, ne pronesi te shitesit.

Persa sipër parashtruar, palet, ne zbatim te nenit 45 te ligjit 7638/1992, jane dakord te perfundojne dhe te nenshkruajne, kete kontrate te shitjes se pjeseve te kapitalit themeltar, ne kushtet dhe modalitet, si vijon :

Neni 1 – Parashtrimet konsiderohen pjese perberese dhe esenciale te kesaj kontrate.

Neni 2 – Shoqeria SIMEST S.p.A. i shet, cedon dhe transferon, shoqerise Tecnosystem Engineering S.r.l., e cila nga ana e saj pranon te bleje, pjeset prej 15 perqind te kapitalit themeltar te shoqerise Q.T.ZH.K. Sh.p.k., sikunder rezulton respektivisht nga akti i themelimit te shoqerise dhe nga Vendimi i Gjykates se Rrethit Tirane, date 23.09.1998, nr.6730/3.

Neni 3 – Pjeset e shitura, sidhe pozicioni i ortakut shites ne shoqeri, shiten dhe blihen respektivisht, ne gjendjen, ne te cilen aktualisht rezultojne te jene nga librat e shoqerise. Ne menyre me te sakte, shoqeria SIMEST S.p.A. shet dhe shoqeria Tecnosystem Engineering S.p.A. blen nepermjet derdhjes bankare shumen ne leke 43.725.000 (dyzeteetremilionshtateqindenjetepesemije).

Neni 4 – Cmimi i ketij transferimi eshte percaktuar nga palet te jete ne shumen komplesive me mire te permendur ne nenin 3, e cila, do te derdhet ne dore, nga blesesi

tek shitesi cedues, i cili me nenshkrimin e dokumentit perkates deklarom se nuk ka me asnje pretendim dhe liron bleresin nga cdo detyrim.

Neni 5 – Efektet e ketij kalimi i referohen, persa i takon gezimit te pjeseve te shitura te kapitalit themeltar, dites se nenshkrimit te kesaj kontrate, per pasoje bleresi do te marre pjese ne fitimet qe do te rezultojne nga bilanci i keti viti financiar.

Neni 6 – Shitesi cedues deklarom se pjeset e shitura jane ne pronesi te tij, te lira nga barret, sekuestrot, sekuestrimet ose kushte te tjere te kesaj natyre.

Neni 7 – Shpenzimet e ketij akti jane ne ngarkim te bleresit.

Lexuar, aprovuar dhe nenshkruar

PALET

Shitesi
Shoqeria SIMEST S.p.A.
Drejtori Pergjithshem
Ing. Massimo D'Aiuto

Bleresi
Shoqeria Tecnosystem Engineering S.r.l.
Kryetari Keshillit Administrativ
Avv. Giovanni Degennaro

Intestato: Av. Lisandro Luciani
Lisandro

Notere
Mymoxa Shetua
Tel. (04) 232 555, (04) 227 125

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
Nr. 248 Rep.
Nr. 95 Kol.



PROCES VERBAL I ASAMBLESË SË ORTAKËVE
QËNDRA TREGTARE DHE ZHVILLIMIT KULTUROR Sh.p.k.
22.02.2017 - Tiranë

Më 22.02.2017, në orën 14.00 në selinë e **QËNDRËS TREGTARE DHE ZHVILLIMIT KULTUROR Sh.p.k.**, në Pallatin e Kulturës, Tiranë - Sheshi Skenderbej u mbledh Asembleia e Përgjithëshme e Ortakëve të Q.T.ZH.K.sh.p.k. për të diskutuar e vendosur mbi pikat e rendit të ditës si më poshtë vijon:

1. Transferim i kuotës shtetërore në pronësi të Bashkisë Tiranë.
2. Të ndryshme dhe eventuale.

Janë të pranishëm ortakët :

- Për Ortakun Italian, Tecnosystem Engineering S.r.l. përfaqsesi i saj ligjor Ing. Canio Scianatico që zotëron 55% të kapitalit shoqëror në Shoqërinë Q.T.ZH.K. Sh.p.k.
- Për Ortakun shtetëror, Ministria e Zhvillimit Ekonomik Turizmit Tregëtisë dhe Sipërmarrjes që zotëron 45% të kapitalit shoqëror në Shoqërinë Q.T.ZH.K. Sh.p.k. përfaqësohet nga Z. Alban Bëqaj me autorizimin datë 20.02.2017, nr.1117/1 prot., lëshuar nga Ministria Znj. Milva Ekonomi, e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Tregëtisë, Turizmit dhe Sipërmarrjes,
- I pranishëm dhe Noteri Muli Mallkuci,
- Janë të pranishëm administratorët e Shoqërisë Q.T.ZH.K. Sh.p.k. Z. Vincenzo Pastoressa, Z. Klidi Baboçi dhe Znj. Miranda Sauku.

I ftuar nga të pranishmit merr drejtimin e Presidencës së Asemblesë Ing. Canio Scianatico, i cili pasi konstaton praninë e të gjithë kapitalit shoqëror e deklaron të vlefshme mbledhjen e Asamblesë së Përgjithëshme të Ortakëve për të diskutuar e vendosur mbi argumentat

e rendit të ditës e ngarkon Znj. Miranda Sauku të kryejë funksionin e sekretares dhe përkthyeses e cila pranon.

Duke marrë fjalën, Presidenti, ju lexon të pranishmëve tekstin e letrës së marrë nga Qendra Tregtare dhe Zhvillimit Kulturor shpk dërguar nga ortaku shtetëror Ministria e Zhvillimit Ekonomik Turizmit Tregëtisë dhe Sipërmarrjes, datë 18.01.2017 me n.289/1 përmes së cilës i bën të njohur Asamblesë së Përgjithëshme të Ortakëve qëllimin e ortakut shtetëror, Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik Turizmit Tregëtisë dhe Sipërmarrjes, për të zëvendësuar vendin e saj në kapitalin shoqëror që ajo posedon në QTZHK Sh.p.k në cilësinë e ortakut shtetëror dhe titullar i kuotës së 45% (dyzetë e pesë përqind) të kapitalit në QTZHK nga Bashkia e Tiranës.

Asambleja e Ortakëve, pasi u njoh me kërkesën e formuluar nga ortaku shtetëror, Ministria e Zhvillimit Ekonomik Turizmit Tregëtisë dhe Sipërmarrjes, titullare e kuotës prej 45% (dyzetë e pesë përqind) të kapitalit shoqëror në Q.T.ZH.K, si dhe me qëndrimin zyrtar të Saj sipas shkresës datë 20.02.2017 me nr. prot. 1117/2 që në kapitalin shoqëror të së njëjtës shoqëri Q.T.ZH.K të hyjë në vendin e saj Bashkia e Tiranës. diskutoi gjerësisht dhe me unanimitet

VENDOSI :

1. Të pranojë kërkesën e formuluar nga ortaku shtetëror Ministria e Zhvillimit Ekonomik Turizmit Tregëtisë dhe Sipërmarrjes, titullare e kuotës prej 45% (dyzetë e pesë përqind) të kapitalit shoqëror në Q.T.ZH.K, me qëllim që në vend të saj në kapitalin shoqëror në të njëjtën shoqëri Q.T.ZH.K, të hyjë në cilësinë e ortakut të ri shtetëror Bashkia Tiranë.
2. Pranimi i kësaj kërkesë të kushtëzohet dhe të varet në mënyrë ekskluzive dhe të detyrueshme nga aprovimi përmes një Vendimi të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, i cili duhet të dalë brenda një afati maksimal prej 60 (gjashtëdhjetë) ditësh nga data e sotme e vendimit të Asamblesë.
3. Të parashikojë që zëvendësimi brenda kapitalit shoqëror në shoqërinë QTZHK për kuotën prej 45% (dyzetë e pesë përqind) të kapitalit shoqëror të ortakut shtetëror, Ministria e Zhvillimit Ekonomik Turizmit Tregëtisë dhe Sipërmarrjes me ortakun e ri shtetëror Bashkia e Tiranës, të prodhojë efektet ligjore vetëm pas datës së daljes së Vendimit të Këshillit të Ministrave të Republikës



së Shqipërisë.

4. Ta bëjë nul dhe të pavlefshëm këtë vendim të Asamblesë nëse brenda afatit prej 60 (gjashtëdhjetë) ditësh nga data e sotme, Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë nuk do të ketë aprovuar zëvendësimin në kapitalin shoqëror të Q.T.ZH.K sh.p.k së kuotës prej 45% (dyzetë e pesëpërqind) të kapitalit shoqëror të ortakut shtetëror Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik Turizmit Tregëtisë dhe Sipërmarrjes me hyrjen në vend të saj të ortakut të ri, Bashkia Tiranë.

Duke mos pasur gjë tjetër për të vendosur dhe pasi askush nuk e kërkon më fjalën, Presidenti deklaron të mbyllur mbledhjen e Asamblesë së Ortakëve në orën 15.30 duke e lexuar paraprakisht dhe duke e firmosur proces verbalin e saj nga të pranishmit.


Pranë zyrave të Shoqërisë Qendra Tregatë dhe Zhvillimit Kulturor Sh.p.k. me seli në Pallatin e Kulturës, Sheshi Skenderbej, Tiranë më datën 20.02.2017, ne praninë time, para meje Noter Muli Y. MALLKUCI, anetar i Dhomes Notereve Tirane, përfaqësuesit e Ortakëve të kësaj shoqërie Z. **Canio Scianatico**, qytetar italian me dokument identifikimi Nr. YA2173302 dhe Z. **Alban Beqja** qytetar shqiptar me dokument identifikimi leternjoftim nr. G90426047L, të cilët pasi redaktuan proces verbalin e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithëshme të Ortakëve, ne gjuhen shqip dhe italisht, nenshkruan regullisht para meje dhe une noteri e vertetoj sipas ligjit.

ORTAKËT


Për TECNOSYSTEM ENGINEERING S.r.l.
Ing. CANIO SCIANATICO



Për MINISTRINË E ZHVILLIMIT
EKONOMISË TURIZMIT
TREGTISE DHE SIPËRMARJES
Me Autorizim nga Ministria
Z. ALBAN BEQAJ



Sekretare dhe Përkthyesë
Miranda Sauku



NOTER
Muli MALLKUCI



ASSEMBLEA GENERALE DEI SOCI
"CENTRO
COMMERCIALE E DELLO SVILUPPO CULTURALE sh.p.k."
22.02.2017 - TIRANA

Il giorno 22.02.2017 alle ore 14.00 presso la sede della Società **"CENTRO COMMERCIALE DELLO SVILUPPO CULTURALE Sh.p.k.,** si è riunita l'Assemblea Generale dei Soci della Q.T.ZH.K.sh.p.k per discutere e deliberare sul seguente ordine del giorno:


1. Trasferimento delle quote statali in possesso del Comune di Tirana.
2. Varie ed eventuali

Sono presenti i soci:

- il socio italiano la Tecnosystem Engineering S.r.l nella persona del suo legale rappresentante, Ing. Canio Scianatico, titolare della quota pari al 55% del capitale sociale nella società Q.T.ZH.K. Sh.p.k.
- il socio statale titolare della quota pari al 45% del capitale sociale nella società Q.T.ZH.K. Sh.p.k., rappresentato dal Dott. Alban Beqaj con autorizzazione del 20.02.2017 con nr. prot. 1117/1 rilasciata dal Ministro dello Sviluppo Economico, Turismo, Commercio ed Imprenditoria, Dr.ssa Milva Ekonomi.
- Sono presenti, inoltre, gli amministratori della Società Q.T.ZH.K. Sh.p.k.: il Sig. Vincenzo Pastoressa, il Sig. Klidi Baboci e la Sig.ra Miranda Sauku.

Su invito dei presenti assume la presidenza dell'Assemblea l'Ing. Canio Scianatico, il quale dopo aver constatato la presenza dell'intero capitale sociale, dichiara l'Assemblea Generale dei Soci validamente costituita per poter discutere e deliberare gli argomenti all'ordine del giorno, e chiama a fungere da segretario e interprete la Sig.ra Miranda Sauku, che accetta.

In riferimento al primo punto dell'ordine dell'giorno, prende per primo la parola il Presidente il quale comunica ai presenti che il socio statale **Ministero dello Sviluppo Economico Turismo Comercio ed Imprenditoria** in data 18 gennaio 2017, con lettera protocollo n° 289/1



che viene esibita durante l'assemblea e archiviata negli atti ufficiali della società, ha formulato una richiesta di convocazione di Assemblea Generale dei Soci avente come ordine del giorno il *"Trasferimento delle quote statali in proprietà al Comune di Tirana"*.

Proseguendo il Presidente, leggendo ai presenti il testo della lettura ricevuta dalla società Centro Commerciale e dello Sviluppo Culturale Shp.k. da parte del socio statale Ministero dello Sviluppo Economico Turismo Commercio ed Imprenditoria, prende atto, e rende nota all'Assemblea dei soci, dell'intenzione del socio statale Ministero dello Sviluppo Economico Turismo Commercio ed Imprenditoria di far subentrare al proprio posto nella compagine sociale del Q.T.ZH.K. Sh.p.k. in qualità di socio statale e titolare delle quote pari al 45% (quarantacinque per cento) del capitale sociale della Q.T.Zh.K. Sh.p.k., il **Comune di Tirana**.

L'Assemblea Generale dei Soci, dopo aver preso atto della richiesta formulata dal socio statale Ministero dello Sviluppo Economico Turismo Commercio ed Imprenditoria, titolare di una quota pari al 45% (quarantacinque per cento) del capitale sociale della società Q.T.ZH.K. Sh.p.k., nonché con la posizione ufficiale da Essa espressa come da lettera del 20.02.2017 e nr. di prot. 1117/2 affinché nella compagine sociale della stessa società Q.T.ZH.K. Sh.p.k. subentri al proprio posto il Comune di Tirana e dopo ampia discussione all'unanimità

DELIBERA

1. Di accettare la richiesta formulata dal socio statale Ministero Dello Sviluppo Economico Turismo Commercio ed Imprenditoria, titolare di una quota pari al 45% (quarantacinque per cento) del capitale sociale di Q.T.Zh.K. Sh.p.k., affinché al proprio posto nella compagine sociale della stessa società Q.T.Zh.K. Sh.p.k. subentri, in qualità di nuovo socio statale, il Comune di Tirana;
2. Di subordinare e vincolare tale accettazione alla sola, esclusiva ed inderogabile approvazione del VKM del Consiglio dei Ministri della Repubblica d'Albania, che dovrà avvenire entro il termine massimo di 60 (sessanta) giorni dalla data della presente delibera;
3. Di prevedere che la sostituzione, all'interno della compagine sociale della società Q.T.Zh.K. Sh.p.k. per una quota pari al 45% del capitale sociale, del socio statale Ministero dello Sviluppo Economico con il nuovo socio statale Comune di Tirana produca efficacia legale solo successivamente alla data di approvazione del VKM del Consiglio dei Ministri della Repubblica d'Albania;



4. Di rendere nulla ed inefficace la presente delibera, qualora nel termine di 60 (sessanta) giorni dalla data odierna, il VKM del Consiglio dei Ministri della Repubblica d'Albania non dovesse approvare la sostituzione, nella compagine sociale di Q.T.Zh.K. Sh.p.k. per una quota pari al 45% del capitale sociale, del socio statale Ministero dello Sviluppo Economico con il subentro del nuovo socio statale Comune di Tirana.

Null'altro essendovi a deliberare, e nessuno più chiede la parola, il Presidente, dichiara chiusa l'Assemblea dei Soci alle ore 15.30 previa lettura e sottoscrizione del presente verbale da parte dei presenti.

I SOCI

Tecnosystem Engineering S.r.l.
Ing. CANIO SCIANATICO

Canio Scianatico

Per il Ministero dello Sviluppo

Economico Turismo
Commercio ed Imprenditoria

Autorizzazione del Ministro
Dott. Alban Beqaj

Alban Beqaj

Segretaria ed Interprete

Sig.ra Miranda Sauku

Miranda Sauku

NOTAIO

Muli MALLKUCI

Muli Mallkuci

REPUBLICA E SHQIPTARE
MULI MALLKUCI
NOTER
TIRANE



Nr. 1117/ Prot.
1

Tiranë, më 20/2 /2017.

AUTORIZIM

Në zbatim të Ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", neni 85 "Përfaqësimi në asamble", me cilësinë e Ortakut Shtetëror në shoqërinë " Qendra Tregtare e Zhvillimit Kulturor "shpk Tiranë, autorizoj Z.Alban Beqaj, Drejtor në Drejtorinë e Administrimit të Pronës Publike, të marrë pjesë në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve, që do të mbahet në datën 22 Shkurt 2017, ora 14.00 në zyrat e shoqërisë.

MINISTRI

MILVA EKONOMI



REPUBLIKA E SHQIPËRIE
MINISTRIA E ZHVILLIMIT
EKONOMIK, TURIZMIT,
TREGTISË DHE SIPËRMARRJES
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PRONËS SHTETËRORE
DREJTORIA E ADMINISTRIMIT TË PRONËS SHTETËRORE

Nr. 1117/2 Prot.

Tiranë, më 20. 2. 2017

Lënda : Qëndrimi që do të mbahet në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve në shoqërinë “ Qendra Tregtare e Zhvillimit Kulturor” shpk Tiranë.

Bazuar në Ligjin Nr.9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, neni 85 “ Përfaqësimi në asamble”, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, me cilësinë e Ortakut Shtetëror në shoqërinë “ Qendra Tregtare e Zhvillimit Kulturor” Sh.p.k Tiranë, në mbledhjen e datës 22 Shkurt 2017, ora 14.00, mban qëndrimin si më poshtë:

- Miraton pikën 1 të rendit të ditës “ Transferimin e kuotave shtetërore në pronësi të Bashkisë Tiranë”.
- Transferimi i pronësisë nga MZHETTS tek Bashkia Tiranë, do të kryhet pas miratimit të Vendimit të Këshillit të Ministrave dhe botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI

MILVA EKONOMI



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2017 – Numri: 70

Tiranë – E mërkurë, 5 prill 2017

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 245, datë 29.3.2017	Për dhënien me qira, me tarifë të reduktuar, të sallës së koncerteve të Pallatit të Kongreseve, Teatrit Kombëtar të Operës, Baletit dhe Ansamblit Popullor..... 4293
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 246, datë 29.3.2017	Për një ndryshim në vendimin nr. 718, datë 29.10.2004, të Këshillit të Ministrave, “Për listën e personave të shpallur si financues të terrorizmit”, të ndryshuar..... 4293
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 247, datë 29.3.2017	Për transferimin në pronësi të Bashkisë Pogradec, në njësinë administrative Çërravë, të pasurisë me nr. 77, në zonën kadastrale 2420, me sipërfaqe 5 900 m ² dhe për një ndryshim në vendimin nr. 417, datë 8.6.2011, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Çërravë, të qarkut të Korçës” 4294
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 250, datë 29.3.2017	Për lirin, mandatin dhe rimandatin e disa anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit..... 4296
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 251, datë 29.3.2017	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 7, datë 11.1.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për punonjësit me kontratë të përkohshme për vitin 2017 në njësitë e qeverisjes qendrore” 4296
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 259, datë 29.3.2017	Për një ndryshim në vendimin nr. 681, datë 28.9.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Tiranë–Elbasan (rrëshqitja në fshatin Ibë)” 4297
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 260, datë 29.3.2017	Për disa ndryshime në vendimin nr. 500, datë 6.7.2010, të Këshillit të Ministrave, “Për emërimin e kryetarit dhe të anëtarëve të këshillit drejtues të Autoritetit të Aviacionit Civil”, të ndryshuar..... 4298

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 29.3.2017	Për një shtesë në vendimin nr. 230, datë 13.3.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për trajtimin me pagesë të qirasë për disa familje që preken nga zbatimi i projektit "Unaza e madhe e Tiranës", segmenti "Komuna e Parisit-Ruga e Kavajës", të ndryshuar.....	4298
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 262, datë 29.3.2017	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 661, datë 8.10.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor, "Skelë-Uji i Ftohtë, Bashkia Vlorë", të ndryshuar"	4299
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 264, datë 29.3.2017	Për kalimin në pronësi, nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes të Bashkia Tiranë, të pasurisë me nr. 2/377, vol. 37, f. 133, ZK. 8380, me emërtim "Godinë njëkatëshe" e Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë Tiranë.....	4299
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 265, datë 29.3.2017	Për transferimin e pronësisë së 45.11% të kuotave të shoqërisë "Qendra Tregtare e Zhvillimit Kulturor" sh.p.k., Tiranë, nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes të Bashkia e Tiranës.....	4303
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 266, datë 29.3.2017	Për dhënien e miratimit për lidhjen e kontratës së qirasë me tarifën 1 euro/kontrata, ndërmjet Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, si qiradhënëse, dhe shoqërisë "Rozafa" sh.p.k., si qiramarrës, për pasurinë "objekte dhe truall, të Agjencisë së Rezervave Materiale të Shtetit Labinot, Elbasan (pjesa e mbetur)", të Ministrisë së Punëve të Brendshme.....	4303
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 269, datë 29.3.2017	Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit.....	4310
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 271, datë 29.3.2017	Për lëvizjen jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë të 18 veprave të artit në pikturë dhe vizatim, pjesë e fondit të Galerisë Kombëtare të Arteve, me qëllim realizimin e ekspozitave "Documenta 14", që do të zhvillohen në ambientet e Muzeut Kombëtar të Artit Bashkëkohor Athinë, Greqi, dhe në Muzeun e Arteve të Bukura, <i>Neue Galerie</i> , Kassel, Gjermani.....	4312
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 274, datë 29.3.2017	Për heqjen nga fondi pyjor dhe kullësor publik dhe pakësimin në volum të sipërfaqes prej 21.56 ha, në objektin "Hotolisht", Bashkia Librazhd, që do të përdoret nga shoqëria "Rosi Construction" sh.p.k., për shfrytëzimin e mineralit të gurit dekorativ.....	4313
Kërkesë e Ministrisë së Zhvillimit Urban, nr. 1956, datë 28.3.2017	Për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private që preken nga realizimi i projektit "Rikualifikim urban i bllokut të kufizuar nga rrugët: "Sulejman Delvina", "Medar Shtylla", "Skënder Luarasi", "Grigor Heba" dhe "Gjik Kuqali" Tiranë.....	4316
Kërkesë e Ministrisë së Zhvillimit nr. 2021, datë 30.3.2017	Për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private që preken nga realizimi i projektit "Urbanizim i zonës informale në lagjen "18 Tetori" Lushnjë.....	4320
	Vendim (i shkurtuar) për shpalljen të zhdukur të shtetasit Ismail Dervishi.	4320

**VENDIM**

Nr. 265, datë 29.3.2017

**PËR TRANSFERIMIN E PRONËSISË
SË 45.11% TË KUOTAVE TË SHOQËRISË
“QENDRA TREGTARE E ZHVILLIMIT
KULTUROR” SHPK, TIRANË, NGA
MINISTRIA E ZHVILLIMIT
EKONOMIK, TURIZMIT, TREGTISË
DHE SIPËRMARRJES TË
BASHKIA E TIRANËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 4, të ligjit nr. 7926, datë 20.4.1995, “Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare”, të ndryshuar, dhe të neneve 3 e 4, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Transferimin e pronësisë së 45.11% (dyzet e pesë pikë njëmbëdhjetë), të kuotave të shoqërisë “Qendra Tregtare e Zhvillimit Kulturor” sh.p.k., Tiranë, nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes të Bashkia e Tiranës.

2. Ngarkohen Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes dhe Bashkia e Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDESKRYEMINISTRI
Niko Peleshi**

VENDIM

Nr. 266, datë 29.3.2017

**PËR DHËNIEN E MIRATIMIT PËR
LIDHJEN E KONTRATËS SË QIRASË
ME TARIFËN 1 EURO/KONTRATA,
NDËRMJET MINISTRISË SË
ZHVILLIMIT EKONOMIK, TURIZMIT,
TREGTISË DHE SIPËRMARRJES, SI
QIRADHËNËS, DHE SHOQËRISË
“ROZAFI” SHPK, SI QIRAMARRËS, PËR
PASURINË “OBJEKTE DHE TRUALL,
TË AGJENCISË SË REZERVAVE
MATERIALE TË SHTETIT LABINOT,
ELBASAN (PJESA E MBETUR)”,
TË MINISTRISË SË PUNËVE
TË BRENDSHME**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe në vijim të vendimit nr. 54, datë 5.2.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontratave të tjera të pasurisë shtetërore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënie e miratimit për lidhjen e kontratës së qirasë me tarifën 1 euro/kontrata, ndërmjet Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, si qiradhenës, dhe shoqërisë “Rozafi” sh.p.k., si qiramarrës, për pasurinë “Objekte dhe truall, të Agjencisë së Rezervave Materiale të Shtetit Labinot, Elbasan (pjesa e mbetur)”, në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Punëve të Brendshme, të Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave të Shtetit, Drejtorisë Rajonale të Rezervave të Shtetit Elbasan, me sipërfaqe të përgjithshme 52 514 (pesëdhjetë e dy mijë e pesëqind e katërmëdhjetë) m², nga e cila 11 659.63 (njëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e nëntë pikë gjashtëdhjetë e tre) m² sipërfaqe e objekteve dhe 40 854.37 (dyzet mijë e tetëqind e pesëdhjetë e katër pikë tridhjetë e shtatë) m², sipërfaqe funksionale, sipas genplanit dhe tekstit të kontratës bashkëlidhur këtij vendimi.